

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje makineri grirese degesh

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
16000000-5**

VLERA E FONDIT LIMIT: 4.116.000 lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Agjencia Parqeve Urbane ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetë deklaramit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kërkesave të kriterëve të shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlera e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3 ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qënë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën e procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit objekt prokurimi është nën kufirin e ulët monetar që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr.285, dt.19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Është minimumi i kërkesës për arsye që të vërtetojë që ka kapacitet financiar për ta kryer këtë furnizim dhe shërbimet e lidhura me to. Rekomandimi nr. 1797/1 i datës 10.03.2022.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4, nenit 55 pika 4 germa b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe tek rekomandimi i nr. 1797/1 i datës 10.03.2022. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë fuqi punetore prej minimalisht 1 (nje) punonjes me kohe të plote, ndër të cilët personelin kryesor, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, i cili duhet të ketë:
 - *Kontratë pune të vlefshme;*
 - *Diplome universitare;*
 - *si dhe të figurojnë në Listpagesat e subjektit për muajin e fundit.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, gërmat b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme, stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën,

2.3.3 Operoret ekonomike ofertues duhet të kenë të pakten 1 (nje) punonjes që të disponojë deshmi trajnimi si “Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.

Për këtë punonjes duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për “Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, e dhënë nga një organizëm i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës (e vlefshme).

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, gërmat b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme, stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Ky kriter konsiderohet i rendesishem për faktin se kjo lloj makinerie nuk ka një përdorim të zakonshëm por kërkon të ketë një person të specializuar për funksionimin e saj në mënyrë që të arrihet siguria dhe mbrojtja e shëndetit në punë ndaj punonjësve të AK.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e kontratës i më poshtë:

Certifikate **ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Certifikate **ISO 45001:2018 (ose ekuivalente)** “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe menaxhimit të sigurisë” e vlefshme ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në proporcion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Certifikata për sistemin e menaxhimit ISO 9001 është e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të vërtetuar dhe garantuar realizimin në kohë dhe me sukses e cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ofroje suport teknik si dhe trajnim për stafin teknik të AK gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës në lidhje me instalimet dhe programimet ku mund të hasen probleme. Për këtë qëllim duhet të paraqesë një deklaratë ku shprehet se merr përsipër përbushjen e këtij kriteri.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) *Automjet me vlerë kapacitet jo më pak se 1 ton* për transportin e mallrave, të cilin duhet t’u ketë në pronësi/qera/marreveshje përdorimi.

Shenim : Për mjetet me status përdorimi qera/marreveshje përdorimi të disponohet kontratë qeraje mes qiradhenesit dhe qiramarresit shoqëruar me librezë qarkullimi, akt koleudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit.

Për mjetet me status pronësi të paraqesë vertetim për pronësinë shoqëruar me librezë qarkullimi, akt koleudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit.

Kriteri konsiderohet i përbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nënjes së afatëve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përbushur dhe ekzekutimin me sukses të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim për të provuar kapacitetet teknike të OE të cilat do të angazhohen në plotësimin e kushteve të kontratës sipas preventivit dhe specifikimeve teknike, në afatin e kërkuar. Kërkesa për disa nga mjetet kryesore të vecanta është bërë bazuar në zërat e preventivit, kështu mjetet do të bëjnë të mundur transportin në vendin e caktuar, mbështetur në zërat e preventivit për mirëfunksionimin e kryerjes së punës në terren e procesit të instalimit, për përfundimin e zbatimit objekt kontratë.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga struktura e posaçme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor konstatohet se plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40 pika 2 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në këto kushte njësisia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit nga të gjithë anëtarët e njësisë që kanë akses (jane te autorizuar) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

NJËSIA E PROKURIMIT